



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	07.11.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	6770/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.891/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.891/2022 të datës 11.10.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë Departmenti i tatimit në pronë Ministria e Financave kundër organit të punësimit, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e Palejuar ankesa A.nr.891/2022 e datës 11.10.2022, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën “ Zyrtare e Lartë për Inspektim” në Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve sipas Akt Emërimit AE.Nr.13/SHC/2022 të datës 06.10.2022, me datë 10.11.2021 ka parashtruar ankesë përmesë E-mailit në ankesa.kpmshec@rks-go.net e cila është protokolluar me numër 6083/2022 me datë 11.10.2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se pozita e punës “Zyrtare e Lartë për Inspektim” duhet të jetë Inspektor i Tatimit siç janë të gjitha pozitat në Divizionin e Inspektimit në Departamentin e Tatimit në pronë pse pretendoj se duhet të jetë Inspektor Tatimor ankesën e mbështes me detyrat e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 19.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa Këshilli me datë 24.10.2022 me numër protokolli 6397/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e vendosjes së kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6083/2022 të regjistruar me numër A.nr.891/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 11.10.2022; E-mail nga L.H. për Z.G. i datës 10.10.2022; E-mail nga Z.G. për L.H. etj. i datës 10.10.2022; E-mail nga Z.G. për L.H. etj. i datës 10.10.2022; Kërkesa për sqarim për pozitën "Zyrtar i Lartë për Inspektim" në Departamentin e tatimit në pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve e datës 05.10.2022; E-mail nga SIMBNJ për L.H. i datës 26.09.2022; Konkurs Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën "Zyrtar i Lartë për Inspektim" në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve i datës 19.08.2022; Njoftim për kandidatin fitues për pozitën "Zyrtar i Lartë për Inspektim" në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve i datës 26.09.2022; Njoftim për listën e ngushtë i datës 16.09.2022; Inspektimi vjetor për tatimin në pronë Komuna Fushë Kosovë për periudhën 01 Janar - 31 Dhjetor 2016; E-mail nga O.D. për L.H. i datës 20.09.2022; E-mail nga E.S. për O.D. i datës 19.09.2022; E-mail nga L.H. për E.S. i datës 16.09.2022; E-mail nga L.Z. për O.D. i datës 12.08.2022; E-mail nga O.D. për S.O. i datës 11.08.2022; E-mail nga O.D. për SH.L. i datës 09.08.2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën "Zyrtar i Lartë për Inspektim" i datës 22.07.2022; Pliko e datës 05.10.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 19.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 6397/2022 i datës 24.10.2022; Akt Emërim i L.H. me numër AE.Nr.13/SHC/2022 i datës 06.10.2022; Akt Emërim i L.H. i datës 01.02.2012; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ i datës 26.09.2022; Konfirmim për përfundimin e konkurimit i datës 06.10.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses [REDACTED] Hedhet poshtë si e palejuar, sepse:

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesja është e punësuar Minsitrinë e Financave Punës dhe Transfereve sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.13/SHC/2022 të datës 06.10.2022 në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë për Inspektim" Departamenti i Tatimit në Pronë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se pozita e punës "Zyrtare e Lartë për Inspektim" duhet të jetë Inspektor i Tatimit siç janë të gjitha pozitat në Divizionin e Inspektimit në Departamentin e Tatimit në pronë pse pretendoj se duhet të jetë Inspektor Tatimor ankesën e mbështes me detyrat e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka analizuar ankesën e ankueses dhe pasi Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ana e institucionit Ministria e Financava Punës dhe Transfereve me datë 24.10.2022 ka konstatuar se në bazë të Konkursit për Lëvizje Brenda Kategorisë të datës 06.09.2022 titulli i pozitës së punës është "Zyrtar i Lartë për Inspektim" Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Andaj duke u bazuar në Akt Emërimin me numër AE.Nr.13/SHC/2022 të datës 06.10.2022 të ankueses e njëjta mbanë pozitën ashtu siç ka qenë e përcaktuar në bazë të konkursit të lartëcekur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo



mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", Kolegji vlerëson se me pretendimet e ankueses me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses lidhur me marrëdhënien e saj të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.891/2022 e datës 11.12.2022, e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.891/2022, datë 07/11/2022

Çlirim Zeka


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

